



E K S T R A K T

nga mbledhja e dytë e Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, mbajtur më 07.12.2022, me fillim në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Amir Simnica, Arianit Beqiri, Pëllumb Bajqinovci, Sami Boroci, Rozafa Fetahaj.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesi i Komitetit z. Amir Simnica me këtë;

R E N D D I T E

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit;
2. Plani i punës për vitin 2023;
3. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbr ojtje të Ambientit

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Pika e dytë

Plani i punës për vitin 2023

Amir Simnica - sa i përket planit të punës për vitin 2023 si pikë e rendit të ditës tha se e kemi shti këtë pikë në rend të ditës për shkak që me e pasur më lehtë për pikat që na vijnë për secilin muaj

Faqe 1 nga 6

qysh kishim me pasur njëfarë rezyme, një fotografi të qartë për një vit çka ka me na ofruar se çka kemi me diskutuar ne në Komitet, meqë ka me pasur ndoshta diçka që është më urgjente edhe e shtimë në rend të ditës pa problem. Ku dhe kuptohet se ndihmën më të madhe na e jepin edhe drejtorët e drejtorive të caktuara pasi që jemi në koordinim dhe jemi në bashkëbisedim thuaje se të rregullt me ta se çka është në interes për Komitetin me e diskutuar.

Ai në vazhdim tha se kam menduar mirë dhe e kemi diskutuar edhe me Samiun që të jemi më të përgatitur edhe thuaje se kjo na e cakton datën e saktë se kur kemi me i mbajtur mbledhjet e Komiteteve, edhe për këtë arsy e kemi shti sot si të vetmen pikë që kemi me e diskutuar që me qenë plani i punës i gatshëm për vitin 2023.

Arianit Beqiri - lidhur me planin e punës shtroi pyetje se a do të shkojmë konceptualisht se çfarë temash kemi me i trajtuar për gjashtë mbledhje brenda viti apo sa janë, pra për dy mbledhjet e mbledhje, apo do të flasim njëherë se kur kemi me i mbajtur mbledhjet, për shkak se do të ishte mirë gjithsesi me u mbajtur para seancës së Kuvendit. Edhe me e caktuar një kohë apo një javë për të cilën e dimë se kemi me i mbajtur mbledhjen tash a do të jetë java e dytë e muajit apo cila është edhe mendoj se tek ky plani i punës do të na vjen prej drejtorive se çka po mendojnë. Por edhe përfund i kam disa propozime të cilat kisha dashur me i parë brenda viti 2023.

Sami Boroci - duke u ndërlidhur në diskutim tha se kur kemi biseduar me kryesuesin ideja ka qenë me e fut edhe planifikimin e mbledhjeve të Komitetit, tjetra është me i pasur në letër disa tema të paktën për gjashtë muajt e parë, me pasur dhe me e ditë secilën p.sh në Janar kemi me trajtuar informatë për Zhvillimin komunal, në Shkurt ndonjë tjeter, nuk di a kishte me qenë mirë me u ul dhe me i këqyr këto tema kjo nuk nënkupton që nëse vjen ndonjë temë tjeter prej Kuvendit që ka me qenë në Kuvend prej ekzekutivit nuk ka nevojë që me u hekë ajo tema që është. Por unë sot kisha propozuar tek perceptimi i temave d.m.th i kishim përcaktuar të paktën gjashtë tema esenciale me i pasur, d.m.th e dimë se në Shkurt do e kemi këtë temë, në Mars këtë temë etj.

Ai në vazhdim tha se tani pres edhe drejtorët se çfarë propozimi kanë por ka me dal njëjtë propozimi mendoj se duhet me i pasur pjesët e planit edhe pastaj pjesa tjeter plotësohet kjo pra është që me qenë njëfarë orientimi për mbledhjet e ardhshme edhe mos të na bënë me u stresuar as ju kryesues dhe zv. kryesues apo kush do se çfarë teme me gjetur tash.

Pëllumb Bajçinovci - tha se mendoj se në vitin 2023 edhe temat që kemi me i trajtuar sigurisht se do të varrën edhe prej pjesës ekzekutive prej drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Strategjik, ato temat me i marr edhe të cilat janë në program atë ditë mendoj se ato i kapim me i drejtuar aty me marr pjesë edhe me qenë në hap për krejt ato proceset që na vijnë para pikave të rëndësishme edhe seancave aktuale.

Mendoj se nuk kishim dalë prej temave është projekti, është programi i kryetarit Rama me drejtorit e caktuara që kanë vlerë specifikaciteti po mendoj duhet me i ndej në temë.

Arbër Sadiki - lidhur me diskutimin e z. Bajçinovci tha se pak a shumë jemi me dhënë informacione shtesë që juve ju nevojiten lidhur me veprimtarit e drejtorive të Komunave, kështu që nuk jam këtu për me imponuar programin që ishte dashur ju me e hartuar, por ne çka mundemi me bërë me e ndarë atë farë sepse janë të lidhura njëra me tjetren pak a shumë atë programin vjetor që ne e bëjmë për veprimtarit e drejtorisë.

Ai në vazhdim tha se unë mendoj se ky Komitet ka me pasur nevojë me i trajtuar temat të cilat nuk kanë me qenë saktë të precizuara tash sepse edhe ne i kemi disa procese para veti të cilat nuk mundemi me e dit afatin kohor saktë se qysh kanë me u zhvilluar. Sepse jemi në hartim e sipër të tri dokumenteve kryesore planore të cilët po e shihni edhe vet që jo gjithmonë shkojnë me dinamikën e paraparë.

Pra po flas për Planin Zhvillimor Komunal, Hartat Zonale më vonë dhe planet e hollësishme. Kështu ato çka kisha mundur me i shprehur këtu është që ne shprehim gatishmërinë tonë për çfarë do lloj teme dhe nëse keni nevojë për informacione shtesë me u pajtuar që vijnë një ditë.

Mimoza Sylejmani - tha se Siç tha edhe Arbëri ne jemi në procedurë të përfundimit të draft dokumentit i cili në këtë vit shkon në Ministri, jemi në fund në fakt jemi duke e lekturuar para se me shkuar në Ministri, dokumenti është diku rrëth 300 faqe i cili ju vjen shumë shpejt, bile juve ka me ju ardhur më shpejt se sa Kuvendit sepse tash më u dakordua se Komiteti ka me u mbajtur para Kuvendit, për momentin që e kam gati prej Ministrisë më së pari kam me i thënë krysesuesit që jo me qenë data e caktuar por në momentin që te kam unë dritën jeshile që na e jap Ministria e Planifikimit ne me e thirr Komitetin, edhe me iu informuar krejt për punët të cilat na i ka dhënë Komiteti për Planin Zhvillimor pastaj del në shqyrtim publik i cili zgjatë një muaj gjegjësisht 30 ditë gjithsej ka me ndej ku minden me i dhënë komentet të gjithë qytetarët së pari ju si Komitet. Edhe shumë më herët kam me ju dërguar në email që me pasur kohë edhe me e lexuar ju si dokument se bukur është voluminoz, pak a shumë Samiu ka qenë edhe në mandatin kaluar në asamble na ka ardhur shumë vonë tri ditë përpara edhe në Kuvend pa miratimin e Ministrisë së Planifikimit, e ka parë që është një dokument voluminoz që nuk e përballon as emaili, me dërguar me email duhet me e pasur usb-n ose cd kështu që ju keni me pasur me kohë rekord si të kthehet prej Ministrisë si draft.

Pastaj me miratimin e planit d.m.th prapë ju bie në Kuvend me e votuar si definitiv, pastaj menjëherë shkojmë me hartën zonale e hapim diskutimin publik, d.m.th kemi me ju informuar për çdo lagje që kemi me pasur diskutim me qytetarët qysh e kemi bërë edhe me Planin Zhvillimor Komunal, e pastaj janë Planet Rregulluese të Hollësishme ku shpresoj dhe besoj që Ministria ka me na kthyer si të ligjshme inicimin e Planit Rregullues "Kalabria", pastaj do të ju mbajmë të informuar se kemi me pasur takime me qytetarë edhe kemi me ju mbajtur si Komitet të informuar edhe pastaj ju dhe kolegët tjerë para se me ardhur në Kuvend që do të jeni më të informuar se të tjerët.

Sami Boroci - tha se në rregull ekzekutivi e ka agjendën e vet me e dit saktësisht se si është plani çfarë tema kur kanë me u trajtuar por po e inicioj për me e lehtësuar punën, por prapë po them organizatori që i cakton mbledhjet mendoj se ne duhet me qitur sot në letër një temë për muajin Janar kjo nuk nënkupton që ka me u mbyll me atë temë rendi i ditës për muajin janar, sepse mundet prapë diçka që ju e vlerësoni që keni vetëm me e shtuar. Por për me e bërë më të lehtë d.m.th me pas njëfarë orientimi mirë është që i kemi edhe drejtorët këtu unë mendoj me i propozuar e pastaj i diskutojmë kam menduar nga 3-4 tema të parat ku në mbledhjen e Komitetit për muajin Janar kishim mundur të diskutojmë për Planin Zhvillimor Komunal kështu që gjatë punës mundet të shtohet edhe ndonjë temë tjetër. Muajin Shkurt e mendova me e pasur informatën për Hartën Zonale, d.m.th se ju duhet me ia filluar me na jap informata për me e ditë si proces se kur planifikohet me qenë Harta Zonale për shkak që në të kaluarën harta zonale ju ka premtuar këtij

Kuvendi që ka me ardhur vitin e parë të mandatit të kaluar, ku drejtori i planifikimit në vitin 2017 e ka marr detyrën dhe ka thënë se 2019-n ka me ardhur harta zonale por nuk ka ardhur asnjëherë. Ai në vazhdim tha se Në seancën e tretë që i bie d.m.th në muajin Mars mundemi me qitura diçka edhe për çështjen e ambientit pasi që si Komitet e kemi edhe ambientin e mundemi me trajtuar ndonjë informatë lidhur me gjendjen e ambientit, e pastaj edhe për planet e hollësishme rregullative që mundemi toni me parë për Kalabrinë për pjesë të caktuara që mundet me i shti.

Mimoza Sylejmani - tha se mundemi me pasur edhe Rregullore për punë kur kemi tek drejtoria e Arbit mundemi me iniciuar bashkë.

Sami Boroci - duke u ndërlidhur me diskutimin e znj. Sylejmani shtroi pyetje se çfarë rregullore me i marr në Kuvend, a mos rregullorja që është shfuqizuar herën e fundit... dashur me kaluar në Kuvend, p.sh a ka tema të tilla që ju potencialisht e keni kryer që minden me kaluar në Komitet.

Arbër Sadiki - tha se besoj që ka me pasur, se pikërisht tash ne po e hartojmë njëfarë dinamike për vitin që po vjen me veprimtari sidomos që lidhen jo me rregullimin se ato pak a shumë shumica ekzistojnë por avancimin e infrastrukturës ligjore e që nuk lidhet me ligjet por me rregulloret, edhe që besoj se së shpejti edhe këto do i ndajmë me ju për ta pasur një informacion të mëhershëm edhe jo me pritur ato rregullore që ne po mendojmë që duhen me u rishqyrtuar, e që janë disa një numër jo i vogël. Një ndër to është e përmendet ambientin edhe rregulloren për eficiencën energjetike, se ne lëshojmë leje e nuk kemi askund një bazë se si bazohemi për dikujt me i thënë që ndërtesa jote është jashtë performancës minimale energjetike etj.

Ai mes tjerash tha se tash filluam me i hartuar disa tema me një organizatë Gjermane se si ishte dashur me u rregulluar një rregullore e energjetikës, edhe në grup iniciues që veç filluam me i ngritur si ide kontaktuan edhe me Ministrinë edhe at thanë veç se qenka një rregullore ekzistuese e ngjashme e kësi kategorie, edhe kjo nuk është mirë tanë me u dubluar bile nuk lejohet as me legjislacion që për të njëjtën çështje me pasur dy rregullativa.

Sami Boroci - shtroi pyetje se a ka pajtim nëse shkojmë me këto tema që i propozova pak i gjeneralë për këta muaj d.m.th për gjashtëmuajrin e parë me pasur njëfarë orientimi.

Amir Simnica - pra do të thotë e kemi për Janar, për muajin Shkurt e kemi procesi për hartën zonale, në muajin Mars e kemi ambientin, në Prill planet e hollësishme.

Mimoza Sylejmani - sa i përket hartës zonale do të ishte mirë të lihet për më vonë pasi që është një hartë siç kanë qenë përpara planet rregulluese, por atëherë ka qenë copa copa, është ndarë qyteti në lagje tash kemi me pas vetëm një hartë e cila i përfshin të gjitha ato, d.m.th është vetëm një hartë në të gjithë territorin e Komunës Prishtinës.

Ajo në vazhdim tha se siç ja u kam shpjeguar në mbledhjen e kaluar i kemi digjitalizuar bukur shumë me platformën GIS e din sepse po punonte në atë platforme, për herë të parë në Komunën e Prishtinës. Nuk është që e dimë edhe unë edhe Arbri shumë mirë si program, Rozafa e din pak më shumë, por s'ka lidhje sepse ne kemi marr ekspert që e dinë GIS shumë mirë dhe jemi duke i trajnuar stafet tonë që i kemi të gjitha drejtorive të cilat kanë të bëjnë me GIS.

Ajo mes tjerash tha se Tashmë ne e kemi ble licencën dhe jemi duke instaluar nëpër kompjuterë me aq sa kemi pas kapacitet dhe buxhet për këtë vit i cili po shkon.

Kështu që është një lajm i mirë dhe janë duke punuar një numër i madh i njerëzve që janë duke i digjitalizuar, kjo i hyn në punë shumë drejtorisë së Urbanizmit, drejtorisë së Pronës, sepse janë digjitalizuar komplet pronat komunale.

Rozafa Fetahaj - sa i përket platformës GIS, tha se GIS është një sistem elektronik lidhur me informatat gjeografike, kjo nënkupton me çdo element të mjedisit: me tokën, me ujin, me klimën, me njeriun do të thotë sjelljet e njeriut, si po shkon Prishtina, si ka qenë para 10 viteve tash si është. Për këtë arsyesh nuk po du të bëjë shumë presion për hartat sezonale sepse kërkon shumë punë, kërkon një ekipë që del në terren, që i bën matjet p.sh për tipin e tokës. Ne në fakultet të bujqësisë e përdorim GIS kur na intereson tipi i tokës për një sipërfaqe të caktuar, por për me dit atë tipin e tokës ne fillimisht duhet të shkojmë në atë arë e marrim një GPS i marrim koordinatat dhe mandej prej sistemit GIS p.sh një banor i Prishtinës po dëshiron me e ditë tipin e tokës dhe me një aplikacion të thjeshtë, me çfarëdo lloj telefoni smart, i merr koordinatat, hyn në sistem GIS dhe automatikisht del tipi i tokës, thjeshtë nuk ke nevojë me thirrë Institutin Bujqësor të Kosovës me ta marrë mostrën dhe me shku me e paguar extra një analizë, kështu që thjesht hin në sistem, mirëpo këto janë punë që kërkojnë ekspertiza të ndryshme, dëshiron kohë. Deri tash nuk e kemi pas mirëpo është një sistem që na lehtëson shumë.

Arianit Beqiri - duke u ndërlidhur me diskutimin e znj. Fetahaj tha se këtu dua të shtoj diçka, nuk e di a kemi të drejtë por mbështetje në këto mbledhje nëse pajtohem me pas secili rend me fol për ambientin, ndonjëherë me ftuar ose drejtoreshën Çetta ose drejtorin e bujqësisë, të cilët mundën me fol diçka më konkretisht. Nëse në një moment flasim për bimët siç tha Rozafa me qenë edhe drejtori i bujqësisë, ose nëse flasim për prerjen e pyjeve që ndodh në sezonin e vjeshtës ose në pranverë me ftuar edhe drejtorin, për krejt çka mundemi me fol edhe me propozuar. Këto tema besoj që kanë përkrahje prej çdo këshilltari komunal dhe mundemi me u dakordu nëse ka nevojë diçka me u votuar për mbrojtjen e pyjeve. Dua të them që nëse 12 muaj me fol për ambientin është shumë e rëndësishme sikur po flasim për harta zonale.

Pëllumb Bajqinovci - tha se pajtohem plotësisht, se temat e mëdha janë temat më të rëndësishme, mundemi me vazhduar.

Sami Boroci - tha se kisha kërkuar prej Arianitit nëse mundemi me i zbërthye këto temat e ambientit që me i pas si pjesë të planit do të kishte qenë shume mirë.

Pra që në njëren prej mbledhjeve kemi me trajtuar degradimin e pyjeve, ta shohim më pas se kë po e involvon kjo drejtoreshën e parqeve apo këndë.

Mimoza Sylejmani - duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësve tha se ju mundeni drejtorinë e parqeve me thirr në sezonë kur është mbjellja, ose drejtorin e bujqësisë. Kështu që kur do që kanë ata sezone që juve i'u intereson si komitet pse jo mundeni me i thirrë Donikën ose Platorin.

Amir Simnica - Atëherë do të thotë kështu shkojmë me këtë renditje që diskutuam, në muajin Janar do ta kemi PZHK, në muajin Shkurt procesi i hartës zonale, në Mars ambienti, parqet, ndotja, mbrojtja

e ambientit, në Prill planet e hollësishme, drejtoresha Mimoza e ceku që mundet me qenë pak herët por mundemi me zëvendësuar me arkitektin e qytetit që e lamë në Maj. Po e potencoj përsëri, kjo nuk do të jetë ajo definitivja sepse na vjen një temë diçka që është më urgjente, automatikisht kemi me u kyç në atë temë me diskutuar në komitet. Kush është për?

Njëzëri u miratua propozimi i z. Amir Simnica për planin e punës për vitin 2023.

Pika e tretë

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesi i Komitetit
Amir Simnica

